

# Raporti për kampin rehabilitues

## Ulqini 2008

23.08.2008 – 04.09.2008



Ky është viti i tetë me radhe që organizohet kampi rehabilitues verore për persona me LPK ( lëndim të palcës kurrizore )që organizon Handikos- i i mbështetur nga Roberto BAZZONI

Në këtë kamp kanë qenë gjithsej 52 pjesëmarrës prej tyre :

➤ Paraplegjik

27



- Tetraplegjik 4
- Tetraparezë dhe Paraparezë 1
- Përcjellës 17
- Stafi ndihmës 3

Stafi udhëheqës i kapit :

### Emri dhe Mbiemri

Afrim Maliqi  
Luan Çabra  
Ilir Gashi  
Rexhep Kuqi  
Taf Fazliu  
Peer support

### Pozita

Menaxher  
Sport  
Vozitës  
Mjek  
Plazhi  
Përgjegjës për aktivitet të kampit

Prej numrit të përgjithshëm të personave me LPK pjesëmarrës për herë të parë janë 4 persona te cilët lëndimi i tyre ka ndodhur këto 2 vite te fundit.

### Qëllimi i Kampit

- Shoqërimi dhe shkëmbimi i përvojave në mes të personave me LPK
- Përdorimi i karrocës ( Pika e ekuilibrit , Manovrimi me karrocë, tejkalimi i barrierave arkitektonike, aktivitetet sportive )
- Argëtimi

### Aktivitetet

- Ushtrimet e mëngjesit ( gjimnastika )
- Garat me karroca
- Transferet
- Përdorimi i karrocës në teren të pa përshtatshëm
- Loja e Basketbollit me karroca
- Loja ndërmjet dy zjarreve me karroca
- Loja e Shahut me karroca
- Loja e pingpongut me karroca
- Vetëdijesimi i për lëndimin dhe inkontinencen për LPK-në
- Mbrëmje argëtuese





- **Shoqërimi dhe shkëmbimi i përvojave në mes të personave me LPK**
  - Vetëdijesimi i për lëndimin dhe inkontinencen për LPK-në

Me të arritur në vendin e caktuar për kamp është bërë akomodimi i pjesëmarrësve, pas darkës në oborrin e hotelit i caktuar për kamp është bërë prezantimi i të gjithë pjesëmarrësve radhazi, një numër nga ta e ka shpalosur përshtypjet nga kampet e viteve të kaluara .

Gjatë ditëve më radhë janë mbajtur takime në mes të personave me LPK për pasojat e lëndimit dhe inkontinencen ku personat me LPK kanë shprehur përvojat e tyre si ju ka ndodhur lëndimi , me çfarë problemesh janë përballë , si i kanë kaluar problemet e lart cekura të cilat kanë qenë përvoja të cilat ju kanë hy në punë personave të cilët kanë probleme të njëjta .

Janë mbajtur dy seanca grupore ku janë trajtuar temat për lëndimin e boshtit kurrizor dhe pasojat urologjike .

- **Përdorimi i karrocës ( Pika e ekuilibrit , Manovrimi me karrocë, tejkalimi i barrierave arkitektonike, aktivitetet sportive )**
  - Ushtrimet e mëngjesit ( gjimnastika )

Gjatë periudhës së kampit në çdo mëngjes janë mbajtur ushtrimet e mëngjesit të cilat kanë pasur për qëllim relaksim të trupit si dhe fitimin e shkathtësisë për qëndrim stabil në karrocë .Pas ushtrimeve të mëngjesit është bërë (manovrimi me karrocë ,pika e ekuilibrit dhe tejkalimi i barrierave arkitektonike ).Prej 5 pjesëmarrësve të cilët nuk kanë pas njohuri për manovrimet me karrocë 5 prej tyre e kanë mësuar piken e ekuilibrit kurse 3 nga ta kanë mësuar tejkalimin e barrierave arkitektonike .



### - **Garat me karroca**

Në këtë kamp janë mbajtur gara me karroca në të cilat janë organizuar prej vendit se ku janë mbajtur ushtrimet e mëngjesit e deri te hoteli pikërisht vendi ku janë mbajtur aktivitetet tjera .Garat tjera kanë qenë :sllallomi me karroca ,garë me qifte ,grim me stafet ,lëvizje mbrapa me karrocë .

### - **Transferet**

Gjatë kohës se ushtrimeve janë demonstrua edhe transferet nga karroca në karrige dhe anasjelltas,nga karroca në shtrat dhe anasjelltas si dhe karrocë tokë dhe anasjelltas. Gjatë demonstrimeve të transfereve nga pirsat,5 persona të cilët nuk kanë pasur njohuri për këtë aktivitet,të gjithë kanë arit ti përvetësojnë transferet nga karroca në karrige dhe anasjelltas dhe karroca shtrat anasjelltas ndërsa dy prej tyre kanë arit që të aftësohen me transferim nga karroca në tokë dhe anasjelltas.



### - **Përdorimi i karrocës në teren të papërshtatshëm**

Në njërin prej ditëve të qëndrimit në kamp është organizuar edhe një shëtitje në teren të papërshtatshëm ku pjesëmarrësit e kampit janë përballur me teren të rërës,baltës dhe pengesave të ndryshme gjatë rrugës,ku disa prej tyre përballen me këso kushte në jetën e përditshme ndërsa nuk kanë qenë në njohuri se mund ti përballojnë edhe teren të tilla për deri sa nuk është mbajtur edhe ky aktivitet.

### - **Loja e Basketbollit me karroca**

Njëra prej aktiviteteve atraktive ka qenë loja e basketbollit në karroca. Personat të cilët nuk kanë paramenduar se mundë të zhvillohet një aktivitet i këtillë , janë përballë me realitetin dhe të kënaqur që ende mund ti zhvillojnë aktivitetet si më parë.

- **Loja ndërmjet dy zjarreve me karroca**

Është njeri ndër aktivitete në të cilin kanë marrë pjesë të gjithë shfrytëzuesit e karrocës, dhe ka lanë përshtypje të mira .

- **Loja e Shahut me karroca**

Loja e shahut është organizuar pothuaj se çdo mbrëmje , ndërsa sistemi garues është organizuar dy ditë radhas ku gjithsejtë kanë qenë 11 garues, ditën e parë janë luajtur lojërat eliminatorë ndërsa ditën e dytë është organizuar gjysmë finalja dhe finalja. Në finale janë takuar Musli Xhoxhaj dhe Halil Kadriu. Fitues i këtij turniri ishte Halil Kadriu.



- **Loja e pingpongut me karroca**

Garat në ping pong janë zhvilluar në tabelën e vendosur në Htotelin Borik dhe kanë zgjatur dy ditë Në këtë garë kanë marrë pjesë 12 garues të cilët kanë shfaqur njohuri fillestare dhe pasion për lojën e pingpongut. Sistemi i zhvillimit të garave ka qenë eliminator,ku në gjiron e parë janë zhvilluar 6 ndeshje,në gjiron e dytë tri ndeshjeve dhe në gjiron e fundit është luajtur finalja në mes të dy më të mirëve.

Fitues i garës është shpallur Samet Salihu ,ku për më të mirin nga HandiKOS-i është ndarë një shpërblim modest.



- **Argëtimi**

- **Mbrëmje argëtuese**

Gjatë periudhës së kampit është organizuar si gjithnjë edhe mbrëmja argëtuese me të gjithë pjesëmarrësit dhe edhe kësaj radhe na u bashkëngjiten edhe pjesëmarrësit nga grupi i personave me aftësi të kufizuar të ndryshme (grupi i III). Si dhe në këtë mbrëmje janë shpërndarë shpërblimet për fituesit e shahut.



- **Të tjera**

Pasi që ka pasur përdorues të mjeteve ndihmëse lëvizëse ( Karroca, paterica), kemi pasur me vete edhe logjistikën gjegjësisht personin përgjegjës për mirëmbajtjen e karrocave.

Gjatë kohës së kampit, një pjesëmarrëse Adelina Berisha kishte ditëlindjen dhe asaj i organizuam një festë dhe ishte hera e dyte e saj që merrte pjesë në kamp.

E veçanta e këtij kampi ka qenë se dy pjesëmarrëse kanë qenë të lënduar këtë vit dmth ende janë qenë në gjendje jo të mirë apo me mirë të themi në depresion të gjendjes së tyre ata janë Sokol Shpendi dhe Shukri Neziri.



**Sokol Shpendi** 27 vjeçar i lindur në Gjakovë është lënduar në vendin e punës

gjegjësisht ka ren nga kati i tret dhe ka pasur fraktura te ndryshme e lëndimin e ka pasur ne unazën C7 ku si pasoi ka humbur lëvizjet ne ekstremitetet e poshtme, probleme me inkontinenc, përdorim te karrocës.

Gjatë qëndrimit ne kamp Sokoli ka qen aktiv ne te gjitha aktivitetet si dhe shume komunikativ për te përmirësuar gjendjen e tij ekzistuese, për at qysh ne ditët e para ka pas qëndrim me te mire ne karrocë si dhe njohuri për inkontinencen.

Sokoli ka qen i shoqërueshëm qysh ne ditën e para te kampit e po ashtu i ka ndihmuar kjo qe te ballafaqohet me sukses me depresionin qe mbretëronte te ky.

**Shukri Neziri** 21 vjeçar i lindur ne Gjilan është lënduar ne aksident komunikacioni dhe ka lënduar boshtin kurrizor ne nivelin T5 ku si pasoi ka humbur lëvizjet ne ekstremitetet e poshtme, probleme me inkontinenc, përdorim te karrocës. Shukriu për dalim nga Sokoli ka qene i mbyllur dhe nuk ka qene fare i shoqëruar me pjesëmarrësit e kampit gjë qe e ka bere ma te vështir kyçje e tij ne aktivite ne fillim por me kalimin e ditëve si dhe dinamiken dhe rendësin e kampit Shukriu është aktivizuar po thuaj ne te gjitha aktivitetet e gjeja ma interesant ka qen interesimi i tij për basketbollin me karroca.

